



EEN Albania Newsletter



1. Innovation festival

Festivali i Inovacionit ne Shqiperi u mbajt në datat 18-20 Qershor në Tiranë. Ky aktivitet mblodhi bashke kompani shqiptare në fushën e inovacionit, institucione kombëtare e ndërkombetare, në një aktivitet për shkëmbim informacioni, raste suksesi dhe takime **B2B**.

Ky festival vijoi për 3 dite me rradhë duke prezantuar sektorë të ndryshëm të ekonomisë



2. “Food for Change, Salone del Gusto 2018”

Dhoma e Tregtisë, Industrisë, Artizanatit dhe Agrikulturës organizoi në datat 20-22 Shtator 2018 në Torino, Itali eventin “Food for Change B2B, Salone del Gusto 2018”. Eventin synonte të sillte bashkë kompani nga vende të ndryshme të botës për të gjetur partnerë të rinj ndërkombëtar.

Sektorët në fokus të këtij aktiviteti ishin eko paketimi; prodhimi i qëndrueshëm; zinxhiri i vlerave digjitale; bujqësia dhe dizajni ushqimor.

Pjesëmarrës në këtë event nga Shqipëria ishin përfaqësues nga AIDA, Cooperazioni Italian në Shqipëri, Këshilli i Agrobiznesit dhe Universitetit Bujqësor.



3. Saranda Info Day

Stafi i EEN - Albania zhvillon ne qytetin e Sarandes, ditën informuese mbi pjesëmarrjen ne Rrjetin European te Ndermarrjeve dhe aksesit ne financa. Gjate takimeve door to door me kompanite mikro, te vogla dhe te mesme te Sarandes, stafi ka informuar dhe asistuar kompanite ne lidhje me procesin dhe kriteret e aplikimit per te qene pjese e Rrjetit dhe per te perfituar mbeshtetje financiare, bashkepunime dhe kontrata biznesi me kompani vendase dhe te huaja, si dhe mundesi per te rinovuar teknologjine dhe per te rritur produktivitetin.

Dy nga kompanite qe kane bere sukses ne kete qytet dhe qe u vizituan dhe asistuan jane: Kantina Isak Sh.P.K., Shtepia e Midhjeve, gjithashtu dhe kompani ne sektorin e bimeve medicinale dhe agro perpunimit.



Vizitoni:

www.een.al

een.ec.europa.eu

